



Nexhat Ibrahim

Kontributi i Imam Ebu Hanifes në fushën e akaidologjisë

Hyrje

Trajtimi i personalitetit shumëpërmasash të Ebu Hanifes dhe i pikëpamjeve të tij polisemike kërkon njohje të gjerë të jetës dhe të veprës së tij gjatë viteve 80-150 h./700-767 dhe njohjen e personaliteteve të tjera fikhere, akaidologjike dhe politike të kohës para tij, gjatë kohës së tij dhe pas tij.¹

Ebu Hanifeh ishte dhe mbeti kolos, gjigant dhe fanar i mendjes njerëzore, besimtar i pathyeshëm dhe zemër e madhe njerëzore. Me fjalën e tij, me veprën e pashembullt dhe me shembullin e tij ishte dhe do të mbetet ideal, drejt të cilit synojnë miliona zemra dhe mendje. Çdo përpjekje e deritashme për ta ndriçuar jetën dhe veprën e tij, paraqesin tentime të zbehta përballë faktit se çka ishte dhe çka paraqet ai për botën islame dhe botën përgjithësisht. Është bindja ime se Ebu Hanifeh nuk është hulumtuar, studiuar dhe analizuar sa duhet në botën muslimane. Veprat e shkruara përkitazi me Ebu Hanifen, janë të pamjaftueshme si në cilësi ashtu edhe në sasi. Për këtë arsye, kemi edhe disa absurde rreth jetës së tij intelektuale.

Edhe shumë shkencëtarë seriozë kanë rënë në kurthin e disa shkencëtarëve dilettante, por edhe të disa tradicionalistëve fanatikë, se Ebu Hanifja vetëm në fillim të jetës së tij është marrë me akaid dhe me shkencat racionale dhe, kinse, duke parë kotësinë e kësaj diturie, ai u dha ekskluzivisht pas çështjeve fikhere. Vetë kronologjia e veprave të Ebu Hanifes, e sidomos *Kitab'ul-vasijeh*, e shkruar kah fundi i jetës së tij, provojnë të kundërtën. Ai deri në fund të jetës luftoi për besim të drejtë, si brenda muslimanëve ashtu edhe jashtë tyre.

¹ Për rrethanat shoqërore-politike dhe shkencore-intelektuale të kohës së paralindjes së Ebu Hanifes shih gjerësisht: M. M. Sharif, *Historija Islamske Filozofije*, II, Zagreb, 1988, fq. 70-84, kurse në arabisht: Muhammed Ebu Zehreh, *Ebu Hanifeh – Hajatuhu we asruhu, arauhu we fikuhu*, (Kairo, 1976), fq. 1-238.

Jeta

Emri i plotë i Ebu Hanifes është Nu'man ibn Thabit ibn Zutah ibn Mah,² siç e thekson vepra *Tabakatu-l-Fukahha*, apo Nu'man ibn Thabit ibn Kavus ibn Hurmuz Merzuban ibn Behram, sipas veprës *Hedjet'ul-arifin*.

Ai është *Imami A'dham* – Imami më i madh, udhëheqësi i muxhtehidëve, Ebu Hanifeh El-Kufi El-Bagdadi, një nga katër imamët më të mëdhenj të ehli sunetit. Thuhet se është me prejardhje persiane.³ Ka lindur në vitin 80 hixhrij/ 700 në Kufe, në kohën e halifit emevit Abdulmelik ibn Mervanit, ku është rritur dhe ka jetuar, kurse ka vdekur në vitin 150 hixhri/ 767 në Bagdad. Sipas disa burimeve, gjyshi i Ebu Hanifes ishte me prejardhje mbretërore persiane nga Kabuli. Ky ishte robëruar në Kabul dhe pastaj u soll në Kufe. Babai i Ebu Hanifes ishte pasues i Aliut r.a. Siç e transmeton En-Neveviu, Aliu r.a. e ka bekuar atë dhe pasardhësit e tij.⁴ Më vonë, imamizmi, por edhe zejdzimi e kanë përvetësuar Ebu Hanifen, duke thënë se ka qenë nxënës i Xha'fer Es-Sadikut, etj.⁵

Ebu Hanifeh tërë jetën e vet ia kushtoi diturisë. Ishte i zgjuar dhe punëtor i palodhshëm. Mësonte Kur'anin, Hadithin, gramatikën, poezinë, letërsinë, filozofinë dhe shkencat e tjera të kohës. Ishte hafidh i Kur'anit, sipas kiraetit të Imam Asimit.⁶ Fikhun, por edhe dituritë e tjera i mësoi prej Sha'biut, pastaj Hamad ibn Ebi Sulejmanit, i cili i ka mësuar dituritë prej Ibrahim El-Nahi'ij, kurse ky prej Alkames dhe Esvedit, e këta prej Abdullah ibn Mes'udit dhe Aliut, të cilët patën mësuar nga shkolla pejgamberike. Kishte edhe shumë mësues të tjerë.⁷

Në kohën e Ebu Hanifes në jetë ishin katër shokë të Pejgamberit alejhiselam: Enes ibn Maliku, Abdullah ibn Ebi Evfa El-Ensariu, Ebu Tufejl Amir ibn Vasile dhe Sehl ibn Sad El-Sadiu.⁸

Si djalë i ri ka shitur mëndafsh dhe ka hulumtuar dituri, që më vonë t'i përkushtohet studimeve dhe dhënies së fetvave. Tregtia dhe prodhimi me tekstil bënë që Ebu Hanifeh të arrijë

2 Shibli Nu'mani, Abu Hanifa – Zivot i djelo, Zagreb, 1996, fq. 17-18.

Shibli Nu'mani shpjegon se nofka (kunja) *Ebu Hanifeh*, që i përshkruhet Nu'manit, dhe që është edhe më e njohur se vetë emri i tij, nuk buron nga emri i djalit të Ebu Hanifes, sepse ai nuk kishte djalë me emrin Hanif. Nofka e ka prejardhjen nga sintagma *Ebu'l-mil-lete el-hanifah* e nxjerrë nga ajeti kur'anor "... *fe't-tebi'û mil-lete ibrahîme hanîfen ...*". (Ali Imran, 95). Op. cit., fq. 23.

3 Sefik Kurdic, Ebu Hanife i namaz u hanefjskom mezhebu, Zenica, 2001, fq. 23-24. Sefik Kurdic, Velikani hadiskih znanosti, Zenica, 2003, fq. 15-59.

4 Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarajevë, 1990, fq. 11. M. M. Sharif, HIF, II, op. cit., fq. 85. Henry Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989, fq. 85.

5 Henry Laoust, op. cit., fq. 85, fusn. 68.

6 Muhammed Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijeh, Kairo, (-), fq. 349.

7 Për jetën dhe pikëpamjet fikhere e tjera të Ebu Hanifes në gjuhën shqipe shih: Nexhat Ibrahim, Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj, botimi II, Prizren, 2000/1421 h., fq. 94-105 etj. M.M. Sharif, II, op. cit., fq. 85-86.

8 Disa thonë se Ebu Hanifeh është takuar me më shumë as'habë: me 5 prej tyre, apo edhe me më shumë. El-Havarizmi thekson emrat e as'habëve dhe pohon se Ebu Hanifeh prej tyre ka transmetuar hadithe. Gjerësisht, për kontributin e Ebu Hanifes në hadith, lexo: M. Omerdić, Ebu Hanifin doprinos hadiskoj nauci, Islamska Misao, 21/1980, fq. 15-18.

Janë bërë vërejtje të rënda, në llogari të Ebu Hanifes, se nuk e ka njohur hadithin, mirëpo vërejtjet e tyre, pa dyshim, janë prodhim i fanatizimit sektar, apo i injorancës intelektuale. Ebu Hanifeh e ka vizituar Qaben 55 herë, ka vizituar Medinen shumë herë, ka diskutuar me Malik ibn Enesin dhe dijetarë të tjerë. Si ka qenë e mundur mos ta mësonte asnjë hadith apo shumë pak hadithe? Lexo: Šefik Kurdić, Ebu Hanife, op. cit., fq. 53-84. Lexo për krahasim: Abdulvehab El-Meshedani, Mënyra e të falurit të Pejgamberit a.s. në frymën e mez'hebit hanefij, Gostivar, 1422 h./2001.

sukses në këtë fushë. Mirëpo, preokupimi kryesor i tij nuk ishte tregtia dhe prodhimi i tekstilit, por dituria.

Fillimisht, Ebu Hanifeh ishte shumë i preokupuar me teologji, logjikë, filozofi, doktrinat sektare e të tjera, dhe ka shpenzuar shumë kohë, duke diskutuar me njerëz të ndryshëm. Ndoshta pas preokupimit të gjatë dhe të mundimshëm me teologji e polemika, e braktisi pjesërisht teologjinë dhe filloi të merret me fikh. Edhe në këtë fushë, ndoqi rrugën e shkollës racionaliste. Pas vdekjes së Hammadit, Ebu Hanifeh u zgjodh mësues i shkollës. Si udhëheqës punoi rreth 30 vite. Për të dhe shokët e tij, thuhet se ka trajtuar dhe hulumtuar rreth 60 mijë, ndoshta edhe 83 mijë çështje juridike. Kishte rreth 700 deri 800 nxënës, të cilët u shtrinë nëpër vende të ndryshme dhe punuan punë të llojllojshme. Në këtë mënyrë, ata shtrinë mësimet e shkollës hanefite. Rreth 50 prej nxënësve të tij u bënë gjyqtarë në kohën e abasitëve. Mësimet e tij u miratuan në pjesën më të madhe të botës muslimane: te abasitët, selxhukët, osmanët dhe mogulët. Edhe sot, shumica muslimane në botë ndjek rrugën e shkollës hanefite.⁹

Jeziid ibn Umer ibn Hubejre, halifi emevit, kërkoi prej tij, që ta pranojë detyrën e kadiut, mirëpo, ky e refuzoi këtë nga frika e përgjegjësisë së detyrës dhe nga devotshmëria.¹⁰ Pas kësaj, edhe halifi abasit Xha'fer El-Mensur kërkoi prej tij që të bëhet kadi në Bagdad, mirëpo Ebu Hanifeh e refuzoi. I provokuar nga ky veprim i Ebu Hanifes, Mensuri u betua se do ta detyrojë Ebu Hanifen ta pranojë detyrën e kadiut, kurse Ebu Hanifeh u betua se do ta refuzojë atë. Këmbëngulësia e halifit dhe parimësia e Ebu Hanifes rezultuan që halifi Mensur ta burgosi. Sipas shumë versioneve, Ebu Hanifeh vdiq në burg nga vuajtjet dhe mundimet. Por ka edhe mendime të tjera, se Ebu Hanifeh doli nga burgu para vdekjes.¹¹

Veprat e Ebu Hanifes

Divergjencat e shkaktuara pas vdekjes së Osmanit r.a. dhe ardhjes së Aliut r.a. për halif, rebelimi i Muaviut kundër Aliut r.a. dhe problemet e tjera të asaj kohe, shkaktuan paraqitjen e katër sekteve të mëdha (shi'ite, harixhite, murxhite dhe mu'tezilite) dhe shpjegime të ndryshme të shtyllave të fesë dhe shoqërisë islame. Ndonëse shumica e besimtarëve ishin në rrugë të drejtë, megjithatë, Ebu Hanifeh ishte ndër të parët prej dijetarëve të mëdhenj, që ka paraqitur në formë të shkruar parimet e besimit islam kundrejt mësimëve sektare dhe heretike në rritje.¹²

Ebu Hanifeh, ndonëse ka punuar dhe zgjidhur shumë çështje shkencore, është e qartë se nuk ka shkruar. Megjithatë, disa nga veprat hanefite i përshkruhen atij. Shibli Nu'mani thekson se vetëm tri vepra janë të Ebu Hanifes: Fikh'ul-ekber, El-Alimu we'l-muteal-limu dhe Musned.¹³ Ibn Nedimi (vdiq më 10 Sha'ban 385/ 17 Shtator 995) pohon se veprat që i përshkruhen Ebu Hanifes, qoftë të shkruara nga dora e tij, qoftë të diktura nga ai te nxënësit e tij, janë:

9 M.M. Sharif, II, op. cit., fq. 86.

10 N. Smailagić, Leksikon, op. cit., fq. 11.

11 N. Smailagić, Leksikon, op. cit., fq. 11.

Ahmed Emin mendon se Ebu Hanifeh vdiq në burg. Duha'l-islam, II, bot. IX, 1979, fq. 183.

Muhammed Ebu Zehreh shtron tri mendime:

1. Vdiq nga torturat në burg;

2. Vdiq i munduar fizikisht nga helmimi.

3. Vdiq në shtëpi nga pasojat e lëndimeve në burg. Muhammed Ebu Zehreh, Ebu Hanifeh, Kairo, 1976, fq. 54-59.

Shih gjerësisht versionet rreth polemikave me Xha'fer El-Mensurin dhe rreth vdekjes së Ebu Hanifes: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 54-55 dhe 56-58.

12 M.M. Sharif, II, op. cit., fq. 88.

13 Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 99.

1. El-Fikh'ul-ekber¹⁴. Veprën e transmeton Ali ibn Ahmed El-Farisiu nga Nusajr ibn Jahja, e ky prej Ebu Mukatil, ky prej Isam ibn Jusufit, ky nga Hammad ibn Ebi Hanifeh, ky nga babai i tij. Tash Kupri-zade në *Miftah'ul-Se`adeh* thotë: “*Ebu Hanifeh ka folur për kelamin sikur në traktatin Fikh'ul-Ekber dhe Kitab'ul-alim ve'l-mute`al-lim dhe në to ka sqaruar numrin më të madh të çështjeve të ilm'ul-kelamit*”. Disa thonë se këto vepra nuk janë të Ebu Hanifes, por të Ebu Hanife El-Buhariut. Mirëpo, këto janë trillime të mu'tezilitëve, të cilët pohonin se Ebu Hanifeh është pasues i doktrinës së tyre. Al-lame El-Bezazi thekson se i ka parë këto dy libra të shkruara me dorën e Imam Kuderit dhe në to shkruan se janë nga Ebu Hanifeh. Në këtë pajtohen shumë dijetarë, sikurse janë: Fahr'ul-islam Bezdeviu dhe Imam Abdulaziz El-Buhariu”.¹⁵

Vepra *Fikh'ul-ekber* e Ebu Hanifes konsiderohet vepra e parë e shkruar në mbrojtje të ehli sunetit (selefinjve: as'habëve, tabiinëve dhe tebei tabiinëve).¹⁶

2. El-Alimu ve'l-muteal-limu. Veprën e transmeton Imam'ul-huda Ebu'l-Mensur El-Maturidiu, nga Ebu Bekr Ahmed ibn Ishak El-Xhuzxhaniut, nga Muhammed ibn Mukatil Er-Raziut, nga Ebu Mukatil Hafsa El-Samarkandiut, nga Ebu Hanifeh.¹⁷ Vepra është shkruar në formë pyetjesh dhe përgjigjesh.¹⁸

3. Risaletun ila Uthman El-Betti. Ka mendime se *Fikh'ul-ebzat* është libri, trajtesa e vetme nga penda e Ebu Hanifes, që është ruajtur deri sot, dërguar Uthman El-Betit.¹⁹

4. Err-Rredu ale'l-kaderijeh.

5. El-Ilmu sharkan we garben (të cilat kryesisht përfshijnë veprat e akaidit dhe da'ves)²⁰.

6. El-Musned. Musned-i është përmbledhje hadithesh të rregulluara sipas emrave të transmetuesve, ashtu që në një kaptinë të përmenden hadithet e transmetuesit të caktuar. Ekzistojnë disa musnede, të cilët i përshkruhen Ebu Hanifes. Në disa burime, theksohen madje 15 prej tyre. Të gjitha këto i tuboi Imam Havarizmi dhe kjo vepër u shtyp në Indi, në vitin 1332. Sot është i njohur Musnedi i Ebu Hanifes, të cilin e tuboi Abdullah ibn Muhamed El-Buhari (vdiq 340 h.), i përpunoi Imam El-Haskafi (vdiq 650 h.) kurse i komentoi Mula Ali El- Kari (vdiq 1014 h.).

Mendohet se pjesën më të madhe të Musnedit e shkroi Ebu Jusufi, kurse pjesën e mbetur Imam Muhammedi, të cilët e quajtën El-Athar.²¹

14 Ebu Hanifeh me emërtimin *fikh'ul-ekber* ka nënkuptuar **ma'rifet'un-nefsi ma leha we ma alejha (Njohje e individit, gjërat në favor dhe kundër vetes)** që d.m.th. “besimi islam, morali etika dhe misticizmi dhe e drejta juridike ose veprimi.” Sipas: Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, Prishtinë, 2002, fq. 48.

15 Et-Taftazani, Sherh'ul-akaidu'un-nesefijeh, op. cit...

Shprehja *Fikh'ul-ekber*, që fjalëpërfjalshëm domethënë ‘Fikhu më i madh’, tregon për prioritetin e shkencës së akaidit kundrejt shkencave të tjera. Imam Taftazaniu thotë: “**Dije se disa nga dispozitat e sheriatit kanë të bëjnë me kualitetin e veprës dhe emërtohen me emra dytësorë praktikë, kurse të tjerët kanë të bëjnë me kualitetin e besimit dhe bindjes dhe emërtohen me emra themelorë. Shkenca që merret me llojin e parë, quhet Ilm'ul-sheraia ve'l-ahkam d.m.th.: Shkenca mbi dispozitat e sheriatit. Shkenca që merret me llojin e dytë, quhet Ilm'ul-tewhid ve'l-sifat d.m.th.: Shkenca mbi njësinë dhe cilësitë e Zotit.**” Sipas: Saduddin Mes'ud ibn Umer Et-Taftazani, Sherh'ul-akaid'in-nesefijeh, op. cit.

Krahaso mendimet rreth kritikës shkencore dhe historike për Fikh'ul-ekberin: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 99, 102-103.

16 Mevlana Halid-i Bagdadi, I'tikadnama (Iman i islam), USA, 1999, fq. 114 e tutje.

17 Et-Taftazani, Sherh'ul-akaidu'un-nesefijeh, op. cit...

Mendohet se nuk ekziston tërë vepra, por pjesë të saj, që burojnë nga Ebu Hanifeh. Sipas: N. Smailagić, Leksikon, op. cit., fq. 12.

18 Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 99.

19 Sipas: N. Smailagić, Leksikon, op. cit., fq. 11. Shih rreth karakterit të veprës: Shibli Nu'man, op. cit., fq. 109-110.

20 Ibn Nedim, El-Fihrist, fq. 285, sipas: Muhammed Ebu Zehreh, Ebu Hanifeh, op. cit., fq. 188.

7. *Kitab'ul-risala*²².

8. *Kitab'ul-wasijjeh*.²³ Mendohet se *Kitab'ul-wasijjeh* është zgjerim i Fikh'ul-ekberit të hershëm dhe Fikh'ul-ebsat.

9. **Fikh'ul-ebsat**. Kjo vepër është e pabotuar deri vonë, ndërsa përmban çështje të besimit që Ebu Hanifeh ia ka dhënë nxënësit të tij Ebu Mutij El-Balhiut (vdiq 799). Në këtë vepër, gjenden gati të gjitha pikat e *Fikh'ul-ekber* të hershëm (i cili ka vetëm dhjetë parime fetare).

Fikh'ul-ebsat përmban edhe një varg thëniesh për çështjet fetare, që përfoleshin në kohën e Ebu Hanifes²⁴.

Doktrina

Në veprat klasike dhe bashkëkohore islame. Ebu Hanifeh është shqyrtuar kryesisht si fekih, jurist e më pak, apo fare pak, si akaidolog dhe teoricien i mendimit të ilm'ul-kelamit. Studimi i historisë së mendimit islam na zbulon Ebu Hanifen si kontribues të madh, të fuqishëm dhe të freskët në fushën e akaidit. Me qëndrimet e tij largpamëse, origjinale dhe intelektuale, ai mbeti në mbrojtje të mësimëve të sunizmit.

Një ndër karakteristikat dominuese në doktrinën e tij është se Ebu Hanifeh njeriun e ngre në nivel të njeriut, zëvendësit të Allahut në tokë (halif), që adhuron Krijuesin, e jo njeriun si adhures të vetvetes, të epsheve dhe gjësëndeve të krijuara.

Ebu Hanifeh i thekson edhe ligjësitë e Krijuesit në gjithësi dhe ligjësitë e të ekzistuarit të çdo gjëje në dimensionin tokësor, kozmik dhe më gjerë (sunneta'll-Llah), për njerëzit të pakuptueshme, ku çdo gjë i nënshtrohet fjalës *kun* (bëhu) dhe ky nënshttrim paraqet apogjenë e ekzistimit të njeriut.

Karakteristikë tjetër e doktrinës së Ebu Hanifes është tewhidi – monoteizmi absolut, pastaj negacioni i ngjashmërisë antropomorfe të Allahut me çfarëdo krijesë e gjësendi.

Ebu Hanifeh i kushton rëndësi të veçantë përgënjeshtimit të mendimeve heretike dhe sektare të eternalistëve (dehrijun), të mu'tezilistëve, të cilët ishin afruar shumë afër nominalizimit indus, pastaj të kaderistëve, xheberistëve, xhehmistëve dhe të disa rrymave të tjera.

Është me rëndësi se Ebu Hanifeh akaidin nuk e kupton si shkencë statike, por si shkencë e cila duhet të zhvillohet bashkë me zhvillimin e jetës, shkencës, kulturës dhe qytetërimit. Zhvillimi shkencor nuk bën t'i paraprijë zhvillimit të mendimit 'teologjik'. Në këtë mënyrë, ideja për Krijuesin do të dominojë të shumica e njerëzve.²⁵

Ebu Hanifeh mendon se akaidi është shkencë që duhet të kultivohet tërë jetën, sepse ajo e mbron dhe e shpjegon fenë, por edhe me atë arrihet shpërbliimi në botën tjetër. Me të drejtë, Ebu Hanifeh konsiderohet themelues i teorisë së *vetëfitimit* dhe *lirisë* së njeriut.

21 Ebu Zehreh, Ebu Hanifeh, op. cit., fq. 191-193. Po ashtu: Mehmed Handzić, Uvod u tefsirsku i hadisku znanost, bot. III, Sarajevë, 1972, fq. 80. (Ekziston edhe përkthimi shqip i veprës së M. Hanxhiqit, Shkup, Logos-A, 1998.)

Rreth Musnedit lexo: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 99-102.

22 Këtë traktat, prej Imam Ebu Hanifes, e transmeton Nusajr ibn Jahja, e ky prej Muhammed ibn Sema' prej Ebu Jusufit, e ky prej Ebu Hanifes. Me këtë sened transmetohet edhe *El-Vasijja*. Sipas: Kemaluddin Ahmed Bejadi, Isharat'ul-Meram min Ibarat'il-Imam, Kairu 21 prill 1949.

23 Ekziston përkthimi në gjuhën shqipe: Edukata islame, nr. 37-38/1983, Prishtinë, fq. 51-56.

24 Veprën e transmeton Ebu Zekerija Jahja ibn Mutarif prej Nusajr ibn Jahja nga Ebu Muti' Hakem ibn Abdullah El-Belhiu nga Ebu Hanifeh. Kemaluddin Ahmed Bejadi, Isharat'ul-Meram.

N. Smailagic, Leksikon, op. cit., fq. 11-12.

Këtë vepër e përmend edhe A. Smajloviq, por me emrin El-Fikh'ul-ebsat. Ahmed Smajlović, Akaidologija, I, material i pabotuar për Fakultetin e Shkencave islame, në Sarajevë.

25 M. Omerdić, Ebu Hanife kao akaidolog, Islamska Misao, 12/1979, Sarajevë, fq. 10-12.

Shkencëtari egjiptian Ebu Zehreh ka vërejtur se doktrina hanefite deri te ne, ka arritur nëpërmjet dy rrugëve:

1. *Transmetimit verbal, përfoljes, mbamendjes* e të tjera, mënyrë kjo, që karakterizohet me mangësi të caktuara, sepse në këto transmetime mund të përvidhen edhe dobësi, mendime të paverifikuara.

2. *Veprave të shkruara* që paraqesin pjesën më të verifikuar. Mirëpo, edhe në këto vepra ka mangësi të caktuara, sikur që janë komentet e përshkruesve, recensionet e ndryshme, glosat etj. gjatë kohës. Por, këto intervenime, megjithatë, nuk e humbin vlerën e përgjithshme të veprave të Ebu Hanifes dhe shkollës hanefite përgjithësisht.²⁶

Në pamundësi hapësinore që të shtrihemi në analizë të hollësishme të çështjeve që shtron Ebu Hanifeh, do t'i cekim në mënyrë kritike disa probleme:

1. Ç'është imani (besimi) dhe a bëjnë pjesë detyrimet dhe veprat në iman?

Kjo pyetje sot është e kapërcyer, por në kohën e Ebu Hanifes ishte mjaft aktuale.

Sot është e ditur se fe do të thotë besim, që paraqet gjendjen e frymës, shpirtit, kurse detyrimet dhe veprat janë aktivitete evidente, të dukshme të organeve njerëzore, dy kategori plotësisht të ndryshme, të cilat nuk mund të kombinohen, e as të ndërrohen.²⁷

Gjatë kohës së as'habëve besimi islam mbeti i paparekur dhe stabil. Edhe gjatë periudhës emevite, me pak përjashtime, arabët nuk ishin të interesuar për shqyrtime të hollësishme filozofike dhe çështje abstrakte. Por me dobësimin e sundimit të emevitëve dhe zhvillimin e kulturës, u rrit interesimi për dituritë intelektuale. Edhe pjesa fetare reagoi dhe kështu erdhi deri tek ashpërsimi i gjendjes dhe te trajtimi i problemeve në mënyrë ekstreme dhe fanatike.

Murxhitët konsiderojnë se besimi dhe veprat janë dy gjëra të ndryshme dhe nëse *besimi* është i përkryer, *veprat* nuk janë me rëndësi. Sipas tyre, nëse besimtari beson sinqerisht në Zotin Një dhe në Muhammedin a.s., si të dërguar dhe njeri të Zotit, por nuk i kryen obligimet e tjera, ky njeri nuk do të ndëshkohet. Reagimi i tradicionalistëve ishte i rreptë, aq sa i shpallën murxhitët për mëkatarë dhe jobesimtarë.²⁸

Ebu Hanifeh ndoqi një rrugë origjinale, në përpjekje për të kuptuar esencën e problemit, ai theksoi se besimi dhe veprat janë gjëra të ndara, që zënë fill në themele të ndryshme.²⁹

Këtë më së miri do ta kuptojmë nëse e lexojmë letrën e përgjigjes së Ebu Hanifes drejtuar Uthman El-Betit, tradicionalistit të njohur të asaj kohe, ku ndër të tjera ai i shkruan: "... A do ta barazojë ti, individin që refuzon ta pranojë Zotin dhe të Dërguarin e Tij, se si dikënd i cili, edhe pse besimtar, është i paudhëzuar, kur ka të bëjë me veprat praktike? Ai që beson dhe, po ashtu, zbaton detyrat, pa dyshim, është besimtar dhe është përcaktuar për xhennet. Ai që i shmanget edhe besimit, edhe veprave, është përcaktuar për xhennem. Ai që beson, por i lë veprat, sigurisht është musliman, por mëkatar. Është çështje e Zotit do ta dënojë apo do ta falë."³⁰

Kjo është metoda islame: në fillim besimtari obligohet me besim dhe vetëm më vonë me detyra. Në ajetet kur'anore, fjalët iman dhe amel, çdokund lidhen me lidhësen kopulative.³¹

26 Gjerësisht: Muhamed Ebu Zehreh, Ebu Hanifeh, op. cit., fq. 186 etj.

27 I këtij mendimi është Shibli Nu'mani, op., cit., fq. 105.

28 Shih: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 106-107.

29 Kjo ishte arsyeja që Ebu Hanifeh dhe pasuesit e tij u quajtën murxhitë.

30 Sipas: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 109-110.

31 "Fa-ja" kopulative në tekstet kur'anore e zgjidh qartë problemin.

2. A zmadhohet apo zvogëlohet imani?

Një ndër çështjet që më së shumti është përfolur nga kundërshtarët e Ebu Hanifes: tradicionalistët, shafiitët dhe disa hanefij, është pohimi i Ebu Hanifes se **“Imani i banorëve të qiellit dhe të tokës nuk zmadhohet, as nuk zvogëlohet (sa i përket vetë besimit, por zmadhohet dhe zvogëlohet në çështjet e bindjes, besimit (tewhidit) dhe konfirmimit (në vepër).**

Duhet pasur parasysh se besimi, mund të zmadhohet apo zvogëlohet në dy pikëpamje:

1. Nga **pikëpamja kualitative** mund të thuhet se besimi mund të bëhet më shumë apo më pak intensiv, siç është rasti me Ibrahimin a.s.

2. Nga **pikëpamja kuantitative** mund të thuhet se besimi nuk zmadhohet apo zvogëlohet, meqë Ebu Hanifeh nuk beson se veprat janë pjesë e besimit dhe se nuk beson se sasia e veprave mund të ndikojë në kuantitetin e besimit. Këtë e ndihmon edhe hadithi i Muhammedit a.s.: **“Ebu Bekri ka përparësi ndaj jush, jo pse fal shumë namaz dhe agjëron, por për shkak të asaj që e ka në zemër.”**³²

Pra, Imam Ebu Hanifeh nuk mohon se besimi mund të zmadhohet (forcohet), apo zvogëlohet (dobësohet) në cilësi, por mohon se kjo mund të bëhet në sasi të besimit dhe ky është përfundim logjik, që mund të rezultojë nga pohimi i tij se vepra nuk është pjesë e besimit.³³

3. Halifët besimdrejtë

Janë edhe disa çështje, të cilat, si në kohën e Ebu Hanifes po ashtu edhe në kohën aktuale, janë interesante. Është çështja e halifëve të drejtë dhe problemi i përparësisë së tyre për t’u zgjedhur halif. Nga kjo rezulton problemi vijues, shumë me rëndësi: A është mënyra e zgjedhjes së halifëve valide dhe nëse jo, a është legjitim vendimi i marrë me ixhma (konsensus) në kohën e tyre? Nëse ka pasur mangësi apo shkelje të rënda, sa janë obligative, për muslimanët e kohëve të vonshme, vendimet e tyre.

Në këtë problem është me rëndësi edhe çështja se si duhet trajtuar *besimi* dhe dallimi e tij nga mosbesimi, pastaj pasojat e mosbesimit, sepse pikërisht, ky problem do të sillte deri te përplasjet e mëdha ndërmjet sekteve muslimane. Kjo nuk është vetëm çështje e besimit, çështje eskatologjike, por është e lidhur fortë me konstituimin e bashkësisë islame. Përgjigja në këto pyetje, ka ndikuar drejtpërsëdrejti në të drejtat qytetare dhe në raportet shoqërore ndërmjet muslimanëve. Po ashtu, konsekuencat e këtyre temave kanë ndikuar të shtrohet edhe pyetja vijuese: A ka kushte për zbatimin korrekt të detyrave fetare, sikurse namazi i xhumasë, ndarja e drejtësisë, pjesëmarrja në luftë etj., nëse shtetin e sundojnë mëkatarët?³⁴

32 Sipas: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 111.

33 Sipas: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 112.

Ebu Hanifeh ishte mjaft tolerant dhe liberal dhe kundërshtarët e tij nuk i akuzon për herezi dhe novatori. Me këtë veprim ai më tepër u ngjan as'habëve, të cilët nuk e akuzonin njëri-tjetrin për renegatje. Shibli Nu'mani thekson një transmetim, ku një njeri e pyeti Abdullah ibn Omerin: **“Disa njerëz, të cilët e komentojnë Kur'anin gabimisht, na akuzojnë neve për jobesimtarë. A janë vetë ata jobesimtarë?”** Abdullah ibn Omeri u përgjigj: **“Askush nuk bën të quhet jobesimtar, nëse nuk pohon se ekzistojnë dy zota.”** Imam Muhammed, Athar, fq. 65, sipas: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 112.

Ebu Hanifës i përshkruhet thënia shumë largpamëse: **“Ndër njerëzit e Kibles, nuk ka asnjë, që mund ta quajmë jobesimtar.”** Sipas: Shibli Nu'mani, op. cit., fq. 113.

34 M. M. Sharif, II, op. cit., fq.88-89.

Ndikimi

Ebu Hanifeh ishte akaidolog i madh, mund të thuhet një nga themeluesit e shkencës së akaidit në ehli sunet dhe mësuesi kryesor i shkollës së mëvonshme të maturidizmit.³⁵ Ai ishte i palodhshëm në mbrojtjen e parimeve të ehli sunnetit. Mendimet e tij, të paraqitura në veprat e shumta të hanefinjve, e ngrejnë Ebu Hanifen në pedestalin më të lartë të shkencës. Vepra e tij *Fikh'ul-ekber*, por edhe të tjerat, edhe pse e shkurtër është gjeniale dhe mund të mësohet përmendësh. Thuajse nuk i mbeti asnjë çështje madhore e kohës së tij pa e trajtuar, pa e mbrojtur fuqishëm dhe argumentueshëm. Mënyra e punës së tij, duke shtruar çështjen para mexhllisit të dijetarëve të shkollës, i bëri parimet e kësaj shkolle vravashkë për të interesuarit dhe të pakonstetueshme, për të gjitha shkollat e besimit, apo ato sheriatike, apo për mendimtarët individualistë.

Në praktikë ndodhi që sistemi juridik që e hartoi mexhllisi privat i juristëve, me në krye Ebu Hanifen, bëhej ligj i vendeve dhe perandorive me shekuj.³⁶ Madje, edhe shumë sisteme moderne juridike të koncipuara sipas modeleve evropiane, si ajo egjiptiane dhe turke, përdorin parimet hanefite të të së drejtës familjare³⁷ dhe pikëpamje të tjera.

Me këtë mendim të lartë për Ebu Hanifen, nuk pretendojmë të themi se **“gjkimet e Ebu Hanifes janë të pagabueshme dhe përfundimtare”**, por pretendojmë se **“qëndrimet e Ebu Hanifes kanë qenë korrekte, aq sa ka qenë e mundshme për një muxhtehid.”**³⁸

Ebu Hanifeh sot

Shkolla e Ebu Hanifes në botën bashkëkohore ka perspektivë afatgjate. Ajo është e vetmja që posedon fuqinë e brendshme dhe metodat efikase për vazhdimin e jetës. Kuptohet, ixhtihadi duhet të rifillojë, e për këtë intelektualët muslimanë të të gjitha shkollave juridike dhe doktrinare, duhet të punojnë shumë më tepër se deri tash, në largimin e divergjencave të deritashme dhe në shqyrtimin e problemeve të reja. Mirëpo, tendencat e unifikimit të medhhebeve, tendencat e mohimit të medhhebeve, tendencat e prozelitizmit në medhhebe, janë pa perspektivë, janë vdekje e islamit ‘të gjallë’. Këto tendenca, me parulla gjithnjë atraktive, por me doktrina sterile, gjejnë hapësirë dhe kushte për plasimin e ideve të tyre, në kohën e krizave politike, ekonomike, sociale dhe intelektuale. Edhe qëndrimi negativ, blasfemues dhe anatemues ndaj Ebu Hanifes, është rezultat i kësaj gjendjeje, i kësaj apatie të besimit ndër ne.

Duke marrë parasysh se e ardhmja ndërtohet në bazë të së kaluarës, njohja e Ebu Hanifes nëpërmjet Fikh'ul-ekberit dhe veprave të tjera të tij, kam bindjen, do të ndihmojë ta njohim më mirë besimin islam, përballë sfidave të njëpasnjëshme të mileniumit të tretë.

35 Mehmed Handzić, Izabrana djela, knjiga VI, Eseji, rasprave, članci, Sarajevë, 1999, fq. 338 e tutje.

36 M. M. Sharif, II, op. cit., fq. 101.

37 G. D. Newby, në: Enciklopedija živih religija, Beograd, 1990, fq. 230.

38 Shih veprën mjaft analitike dhe informative: Shibli Nu'mani, Abu Hanifa – život i djelo, Zagreb, 1996, fq. 223.

Literatura:

1. Abdulvehab El-Meshedani, Mënyra e të falurit të Pejgamberit a.s., në frymën e mez'hebit hanefij, Gostivar, 1422 h./2001.
2. Ahmed Emin, Duha'l-islam, II, bot. IX, 1979.
3. Ahmed Smajlović, Akaidologija, I, material i pabotuar për Fakultetin e Shkencave islame në Sarajevë, Sarajevë, pa vit botimi.
4. Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, Prishtinë, 2002.
5. Edukata Islame, revistë fetare islame, nr. 37-38/1983, Prishtinë.
6. Enciklopedija živih religija, Beograd, 1990.
7. Henry Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989.
8. Islamska Misao, 12/1979, 21/1980, Sarajevë
9. Kemaluddin Ahmed Bejadi, Isharat'ul-Meram min Ibarat'il-Imam, Kairu, 1949.
10. M. M. Sharif, Historija Islamske Filozofije, II, Zagreb, 1988
11. Mehmed Handzic, Izabrana djela, knjiga VI, Eseji, rasprave, članci, Sarajevë, 1999.
12. Mehmed Handžić, Uvod u tefsirsku i hadisku znanost, bot. III, Sarajevë, 1972
13. Mehmed Hanxhiq, Hyrje në shkencat e hadithit, Shkup, Logos-A, 1998.
14. Mevlana Halid-i Bagdadi, I'tikadnama (Iman i islam), USA, 1999.
15. Muhammed Ebu Zehreh, Ebu Hanifeh – Hajatuhu we asruhu, arauhu we fikhuhu, (Kairo, 1976.
16. Muhammed Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijeh, Kairo, (-).
17. Nerkez Smailagić, Leksikon islama, Sarajevë, 1990. Nexhat Ibrahim, Shkolla juridike hanefite dhe karakteristikat themelore të doktrinës së saj, botimi II, Prizren, 2000/1421 h..
18. Šaduddin Mes'ud ibn Umer Et-Taftazani, Sherh'ul-akaid'in-nesefijeh, Bejrut (-).
19. Šefik Kurdić, Ebu Hanife i namaz u hanefjskom mezhebu, Zenica, 2001.
20. Šefik Kurdić, Velikani hadiskih znanosti, Zenica, 2003.
21. Shibli Nu'mani, Abu Hanifa – Život i djelo, Zagreb, 1996.
22. www.islamic-paths.org/Home/English/History/Personalities/Content/Hanifa.htm.